



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr ____prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 266, datë 24.05.2024

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË: GJYKATËN
E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN
NR. 247, DATË 02.05.2024; SI EDHE NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS
CIVILE TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 244, NR. 245, DHE NR. 246 DATË
02.05.2024 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
2. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
3. Për kandidatin z. {...} - relator z. {...};
4. Për kandidatin z. {...} - relator z. {...};
5. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
6. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
7. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
8. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
9. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
10. Për kandidatin z. {...} - relator z. {...};
11. Për kandidatin z. {...} - relator z. {...};
12. Për kandidatin z. {...} - relator z. {...};
13. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
14. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
15. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
16. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
17. Për kandidaten znj. {...} - relator z. {...};
18. Për kandidatin z. {...} - relator z. {...};

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR